



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr.262, datë 23.07.2020

PËR
VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...}
TË KATËR KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN
NR. 91, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE
VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA
LIGJORE TË KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 23.07.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e katër prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të kandidatës znj. {...}”, për gatitur nga relatori z. Ilir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 91, datë 26.02.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

...

3. Afati i kandidimit është tetë javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

...”.

2. Ky vendim i Këshillit si më lart është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 28.02.2020, duke filluar të ecë afati i kandidimit nga dita e nesërme, pra nga data 29.02.2020.

3. Afatet e kandidimit për procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përfshirë edhe për procedurën si më sipër, u pezulluan nga Këshilli më datë 12.03.2020, për shkak të situatës së krijuar në vend nga përhapja e Covid-19, ndërkohë që me Vendimin e tij nr. 142, datë 22.04.2020, këto afate u zgjatën edhe për një periudhë tjetër të caktuar. Konkretisht, për pozicionin e katërt të lirë, që i korrespondon Vendimit nr. 91, datë 26.02.2020, afati i kandidimit u zgjat me katër javë, duke përfunduar ai më datë 20.05.2020.

4. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e katërt të lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 91, datë 26.02.2020, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

5. Me Vendimin nr. 191, datë 04.06.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Caktimin e relatorit si më poshtë: ... I. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Ilir Toska; ...”.

6. Më datë 04.06.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

7. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidates, në kuadër të ngritjes në detyrë, në kushtet kur kandidatja është subjekt rivlerësimi “*ex officio*” sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, proces ky që nuk ka përfunduar për këtëandidate, si dhe kur referuar nenit 162, pika 7, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

dhe nenit 57, pika 11, të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, për kandidatët që aplikojë në procedurat e ngritjes në detyrë për në gjykatat e specializuara, verifikimi i pasurisë dhe figurës bëhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit sipas Ligjit nr.84/2016, ç’ka përcaktohet edhe në Kreun X, Seksioni A, të Vendimit 75/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Shkresën nr. 2258/1 prot., datë 08.06.2020, i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidates.

9. Më datë 05.06.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërgua Autorizimi “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe Deklarata “Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, sipas pikës 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, meqënëse verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidatë do të kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, sikurse edhe konfirmohet, pas kërkesës së Këshillit, me Shkresën nr. 3968/1 prot., datë 09.06.2020 të këtij Institucioni.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

11. Për këtë kandidatë, është kërkuar informacion pranë strukturës së posaçme të Këshillit, në lidhje me verifikimet e kryera në zbatim të Ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, meqënëse në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kandidatja ka qenë gjyqtare dhe i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji dhe institucioni përkatës ka kthyer përgjigje në lidhje me sa është kërkuar.

12. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr.91, datë 26.02.2020, është përcaktuar se: “Për kandidatën, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b”, “ç” dhe “d” të pikës 5 të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional:...”. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit si më lart të Këshillit, përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale”. Nga ana tjetër, në shkronjat “b”, “ç” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij Vendimi, përcaktohet se: “b) Kandidati duhet të japë pëlqimin (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

13. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të katër kritereve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave për ngritjen në detyrë, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares.

13.1 Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr.2258 prot., datë 17.06.2020, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

13.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht sa i përket “përvojës specifike profesionale” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale/drejtësinë kriminale, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit dhe gjyqtarit të komanduar, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në Gjykatën e Lartë, informacioni iu kërkua të dyja këtyre gjykatave. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 477 prot., datë 19.06.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2258/12 prot., datë 25.06.2020, si dhe me Shkresën nr. 519 prot., datë 07.07.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2258/14 prot., dtë 14.07.2020, siç do të përshkruhet më poshtë. Ndërsa nga Gjykata e Lartë informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 1283 prot., datë 18.06.2020, protokolluar në Këshill me aktet nr. 2258/10 prot. dhe nr. 2258/11 prot., datë 18.06.2020, siç do të përshkruhet më poshtë. Ndërkohë, në lidhje me këtë kriter është administruar edhe Vërtetimi nr. 354 prot., datë 13.05.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, paraqitur nga vetë kandidatja në rastin e shprehjes së interesit për kandidim.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR KATËR KRITERET E KANDIDIMIT

14. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

15. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 91, datë 26.02.2020, është parashikuar si kriter kandidimi, në nenin 47, pika 5, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: “Për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se

dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

16. Për verifikimin e kandidatës në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u mbajt parasysh se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, pra jo më pak se dhjetë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale.

17. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008. Ajo ka kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga data 05.10.2007, ndërkohë që, pas përfundimit të stazhit profesional, kandidatja ka marrë edhe emërimin përfundimtar po në këtë gjykatë. Më pas, në periudhën 15.11.2012 deri në 15.11.2015, kandidatja është komanduar në pozicionin e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Pas përfundimit të periudhës së komandimit, kandidatja është rikthyer përsëri në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku vijon të ushtrojë funksionin e gjyqtarit, në seksionin civil të përgjithshëm, por e ngarkuar edhe si gjyqtare e hetimeve paraprake apo edhe për plotësimin e trupave gjyqësore të seksionit penal.

18. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, ka filluar detyrën si gjyqtare sipas Dekretit nr. 4581, datë 05.10.2007 të Presidentit të Republikës, dhe me Dekretin nr. 6112, datë 25.03.2009, të Presidentit të Republikës, është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Më pas, znj. {...} me Vendimin nr. 297/7, datë 15.11.2012, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është lejuar për të shërbyer¹ për një periudhë trevjeçare në detyrën e ndihmësit ligjor të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, në përfundim të së cilës është rikthyer në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku vijon të ushtrojë funksionin dhe aktualisht.

19. Periudha trevjeçare e shërbimit të kandidatës si ndihmëse ligjore e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, referuar ligjit të kohës², njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të karrierës profesionale. Po ashtu, edhe ligji aktual në fuqi, Ligji për Statusin, në pikën 9, të nenit 53, përcakton: *“Përvoja e magjistratit të komanduar nga gjykata ose prokuroria e shkallës së parë në institucionin në të cilin magjistrati komandohet, llogaritet përvojë në profesion në shkallë të parë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe”.*

20. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e

¹ Komanduar sipas terminologjisë së përcaktuar nga ligji aktual, Ligji për Statusin.

² Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë (pika 3, e nenit 28).

lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 91, datë 26.02.2020, ka mbi dhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale”.

21. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi të kandidates, evidentohet se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për periudhat 05.10.2007 - 15.11.2012 dhe 15.11.2015 e në vijim, ajo ka gjykuar çështje të karakterit administrativ, civil dhe penal, ku në këto të fundit si gjyqtare e hetimeve paraprake dhe si plotësuese e trupave gjykuese të seksionit penal.

22. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me Shkresën me nr. 477 prot., datë 19.06.2020, rezulton se:

“... Gjyqtarja {...} ka ushtruar funksionet e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër prej datë 05.10.2007 deri më datë 15.11.2012, ku caktohet ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, si dhe nga data 15.11.2015 e në vijim.

Gjatë kësaj periudhe ka qenë pjesë e seksioneve gjyqësore si më poshtë:

...

5. Për vitin 2016 ka qenë pjesë e trupës gjykuese, Seksioni Civil (urdhëri nr. 178, datë 31.12.2015), ku gjykon edhe çështjet penale me karakter të ngutshëm;

6. Me urdhërin nr. 69, datë 26.04.2016, vazhdon të ushtrrojë funksionet në seksionin civil duke gjykuar çështjet me karakter të ngutshëm sipas pikës 10 të këtij urdhëri;

7. Me urdhërin nr. 24, datë 28.01.2019, vazhdon të ushtrrojë funksionet në seksionin civil duke gjykuar çështje me karakter të ngutshëm, vleftësime etj.

Gjithashtu referuar urdhërave që ju përcjell bashkëlidhur, gjyqtarja ka gjykuar çështje penale të karakterit të ngutshëm....”.

23. Referuar Vërtetimit nr. 354 prot., datë 13.05.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, paraqitur nga vetë kandidatja në rastin e shprehjes së interesit për kandidim, rezulton se në vitet 2015 - 2020, ajo ka gjykuar çështje penale si vijon: 29 çështje si kryesuese e trupit gjykues; 3 çështje si anëtare e trupit gjykues; 25 kërkesa penale; 485 kërkesa për caktim mase sigurimi, ndërsa ka për gjykim 2 çështje penale si kryesuese e trupit gjykues dhe 2 çështje të tjera si anëtare e trupit gjykues.

24. Ndërkohë, sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me Shkresën me nr. 519 prot., datë 07.07.2020, rezulton se, sipas regjistrit themeltar të personelit, fleta nr. 80, gjyqtarja {...} ka filluar punën si gjyqtare më datë 05.10.2007, në stazhin profesional. Referuar urdhërave të kryetarëve të gjykatës, znj. {...} është shortuar menjëherë më fillimin e detyrës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë. Në përmbajtje të kësaj Shkrese është dërguar, gjithashtu, informacion në lidhje më çështjet penale të gjykuara nga kandidatja për periudhën 2007

- 2012³, nga ku rezulton se ajo ka gjykuar çështje të kësaj natyre edhe gjatë periudhës gjashtëmbëdhjetë mujore të stazhit profesional (05.10.2007 - 25.03.2009). Në këtë shkresë është dërguar një informacion i tillë edhe për periudhën 2015 - 2020⁴.

25. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Lartë, rezulton se:

“... znj. {...} ka punuar me detyrën e Ndhmëses Ligjore, në Kolegjin Penal, pranë Gjykatës së Lartë, nga data 16.11.2012 deri më datën 16.11.2015...”

26. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 91, datë 26.02.2020, ka mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

27. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

³ Për vitin 2007, kandidatja ka gjykuar në total 5 çështje me natyrë penale, nga këto: 3 masa sigurimi dhe 2 kërkesa penale.

Për vitin 2008, kandidatja ka gjykuar në total 42 çështje me natyrë penale, nga këto: 33 masa sigurimi, 8 kërkesa penale dhe 1 penale.

Për vitin 2009, kandidatja ka gjykuar në total 54 çështje me natyrë penale, nga këto: 44 masa sigurimi dhe 10 kërkesa penale.

Për vitin 2010, kandidatja ka gjykuar në total 83 çështje me natyrë penale, nga këto: 66 masa sigurimi, 16 kërkesa penale dhe 1 penale.

Për vitin 2011, kandidatja ka gjykuar në total 98 çështje me natyrë penale, nga këto: 77 masa sigurimi, 20 kërkesa penale dhe 1 penale.

Për vitin 2012, kandidatja ka gjykuar në total 64 çështje me natyrë penale, nga këto: 57 masa sigurimi, 6 kërkesa penale dhe 1 penale.

⁴ Për vitin 2015, kandidatja është shortuar dhe ka gjykuar 14 masa sigurimi.

Për vitin 2016, kandidatja është shortuar në total me 133 çështje penale, nga këto: 117 masa sigurimi, 10 kërkesa penale dhe 6 penale. Ndërkohë të gjykuara në këtë periudhë ka pasur 129 çështje në total, nga këto: 117 masa sigurimi, 7 kërkesa penale dhe 5 penale.

Për vitin 2017, kandidatja është shortuar në total me 101 çështje penale, nga këto: 90 masa sigurimi, 2 kërkesa penale dhe 9 penale. Ndërkohë të gjykuara në këtë periudhë ka pasur 105 çështje në total, nga këto: 90 masa sigurimi, 5 kërkesa penale dhe 10 penale si kryesuese dhe 2 si anëtare.

Për vitin 2018, kandidatja është shortuar në total me 143 çështje penale, nga këto: 126 masa sigurimi, 8 kërkesa penale dhe 9 penale. Ndërkohë të gjykuara në këtë periudhë ka pasur 142 çështje në total, nga këto: 126 masa sigurimi, 8 kërkesa penale dhe 8 penale.

Për vitin 2019, kandidatja është shortuar në total me 122 çështje penale, nga këto: 115 masa sigurimi, 4 kërkesa penale dhe 3 penale. Ndërkohë të gjykuara në këtë periudhë ka pasur 120 çështje në total, nga këto: 114 masa sigurimi, 3 kërkesa penale dhe 3 penale si kryesuese dhe 1 si anëtare.

Për vitin 2020, kandidatja është shortuar në total me 39 çështje penale, nga këto: 36 masa sigurimi, 2 kërkesa penale dhe 1 penale. Ndërkohë të gjykuara në këtë periudhë ka pasur 38 çështje në total, nga këto: 35 masa sigurimi, 3 kërkesa penale dhe ka 2 çështje penale në gjykim si anëtare.

28. “Dhënia e pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si kriter për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 91, datë 26.02.2020, është parashikuar në pikën 4, të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: “...Kandidatët për gjyqtarë ... në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, ... japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit”. Po ashtu, ai gjen parashikim edhe në nenin 47, pika 3, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Kjo dispozitë ligjore është një dispozitë referuese e cila referon konkretisht në nenin 48, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, që përcakton se: “1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë ... në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, ... firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë 2. Anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga të drejtat, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet...”.

29. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja znj. {...} ka depozituar:

- Formularin “Vetëdeklarim (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidatja, znj. {...}, i datës 14.05.2020;
- Formularin “Vetëdeklarim (i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; i prokurorëve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme; i drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesit, oficerit të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit”, Shtojca B, Deklarata 3, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga bashkëshorti i kandidates, z. Mentor Bimi, i datës 14.05.2020.

30. Nga dokumentacioni i administruar, Këshilli vlerëson se kandidatja dhe familjarët e saj, konkretisht bashkëshorti, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, duke plotësuar kështu kriterin e “Dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/ 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucionave për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

31. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

32. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 91, datë 26.02.2020, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë*”.

33. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 14.05.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “*Nuk kam masë disiplinore në fuqi*”.

34. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

35. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

36. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

37. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “d”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 91, datë 26.02.2020, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë*”. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: “*Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë*”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: “*Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni*”.

38. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 14.05.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “*Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë*”.

ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

39. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

40. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

41. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr. 91, datë 26.02.2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të katër kriterëve formale të kandidimit të znj. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

42. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të katër kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të katër kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 91, datë 26.02.2020.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 4 të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në shkronjën “b” të pikës 2 dhe në pikën 3 të nenit 47, në pikën 7 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 91, datë 26.02.2020, “Për hapjen

e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 91, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 91, datë 26.02.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR